



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2018:038988

Datë: 08.12.2023

Numri i dokumentit: 05035252

NE ËMËR TE POPULLIT

P.nr.184/12

GJYKATA THEMELORE PEJË- Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Leon Përlaska me procesmbajtëse Shpresa Kërnya në çështjen penale kundër të pandehurit Sh. K. nga Peja, për shkak të veprës penale Uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtëshme nga neni 259 par.1 të Kodit të Përkohëshëm Penal të Kosovës (KPK) dhe veprës penale Heqja a po dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 322 par.1 të KPK-së, sipas Propozim akuzës së Prokurorisë Komunale ne Gjakovë PP.nr.84/12 të datës 28.02.2012, në seancën publike të shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 22.11.2023, në prezencë të Prokurorit të shtetit Qazim Xharra, përfaqësuesit të palës së dëmtuar V. D. dhe te pandehurit Sh. K., me datë 23.11.2023 shpalli ndërsa me datë 08.12.2023 përpiloi këtë :

AKTGJYKIM

Ndaj të pandehurit:

Sh. K. i lindur me ne Peje ,nga i ati R. dhe nena N. e gjinisë B., me vendbanim Rr. “M. M.” Lagjia F., ka te kryer shkollën e mesme, punëtor ne zyrën për punësim ne Peje, i martuar babi i 2 fëmijëve, me gjendje te dobët ekonomike , me nr personal te letërnjoftimit shqiptar shtetas i Republikës se Kosovës.

Në bazë të nenit 362 par.1 pika 1.3 te KPRK-së,

I. REFUZOHET AKUZA

Për shkak se:

Me datë 16.01.2012 në pronën në Rr. “F.” F2, Ap 4 në Pejë, ka hequr vulën zyrtare-shenjen e ngjitur nga personi i autorizuar i HPD (Agjencia Kosovare e Pronës), ka hapur objektin e

siguruar dhe ka hyrë duke ripushtuar pronën, gjendje kjo e konstatuar nga personat e autorizuar te HPD me dt.17.01.2012.

- Me këtë kishte për të kryer veprën penale Heqja a po dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 322 par.1 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës.

Në bazë të nenit 363 par.1 pika 1.1 te KPRK-së,

II. LIROHET NGA AKUZA

Për shkak se :

Nga dt.16.01.2012, e deri me tani në Pejë, i pandehuri në mënyrë të kundërligjshme pushton banesën në të cilën e ka të drejtë banimi R. B., e cila administrohet nga AKP në rrugën F. F2 AP.4 në sipërfaqe prej 72.20 m2, në të mënyrë pasi që paraprakisht dëbohet nga kjo banesë të cilës i vihet edhe shenja zyrtare nga personave të autorizuar nga H. (tani AKP) i njëjti i heq këto vula dhe përsëri e ripushton në mënyrë të kundërligjshme pronën e paluajtshme, kjo gjendje konstatuara nga persona të autorizuar të HPD me dt.17.01.2012.

-me çka kishte për të kryer veprën penale Pushtim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 259 par.1 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës.

III. Shpenzimet e procedurës mbeten në barrën e mjeteve buxhetore te gjykatës.

IV. E dëmtuara KPA, udhezohet që këkesën pasurore juridike ta realizoj në kontest të rregullt civil.

ARSYETIM

a) Historiku i çështjes;

Prokuroria Komunale në Gjakovë pranë kësaj gjykatë ka parqitur Propozimkuzën PP/II.nr.84/2012 të datës 28.02.2012, kundër të pandehurit Sh. K. për shkak të veprës penale Heqja a po dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 322 par.1 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës dhe veprës penale Pushtim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 259 par.1 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës.

Gjykatat e mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale me datë 22.11.2023 , në të cilën seancë prezentuan prokurori i shtetit Qazim Xharra, perfaqesuesi i të dëmtuarës KPA V. D. dhe i pandehuri Sh. K..

Për veprën penale Heqja a po dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 322 par.1 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës gjykata në kuptim të nënit 362 par.3 të KPPRK-së mori aktgjykim refuzues, për shkak se gjeti se në lidhje me këtë veper penale është arritur afati i parashkrimit absolut të ndjekjes penale, gjë të cilën e potencoj edhe prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare, na vazhdim të arsytimit do të trajtoj shkurtimisht këtë pjese.

Përqendrimi i gjykatës do të jetë në arsytimin e vendimit në lidhje me aktgjykimin lirues sa i përket vepres penale Pushtim i paligjeshëm i pronës së paluajtshme nga neni 259 par.1 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës.

b) Faktet e çështjës (pretendimet e akuzës) ;

Prokurori i Shtetit në aktakuzë e riformuluar në shqyrtim gjyqësor, pretendon se i pandehuri Sh. K. nga dt.16.01.2012, e deri me tani në Pejë, në mënyrë të kundërligjshme pushton banesën në të cilën e ka të drejtë banimi R. B., e cila administrohet nga AKP në rrugën Fidanishte F2 AP.4 në sipërfaqe prej 72.20 m2, në atë mënyrë pasi që paraprakisht dëbohet nga kjo banesë të cilës i vihet edhe shenja zyrtare nga personat e të autorizuar nga Habitati (tani AKP) i njëjti i heq këto vula dhe përsëri e ripushton në mënyrë të kundërligjshme pronën e paluajtshme, kjo gjendje konstatuara nga persona të autorizuar të HPD me dt.17.01.2012.

Nga ky përshkrim shihet se prokuroria ka renditur faktet mbi bazën e të cilave e akuzon të pandehurin se e ka uzurpuar pronën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke paraqitur si veprim të kryerjes faktin se i ka hequr vulat zyrtare dhe është futur në banesën në fjalë.

c) Baza ligjore (Vepra penale me të cilën ngarkohet i pandehuri);

I pandehuri akuzohet se ka kryer veprën penale Pushtim i paligjeshëm i pronës së paluajtshme nga neni 259 par.1 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, e cila vepër e ka këtë përshkrim:

“ Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme pushton pronën e paluajtshme të personit tjetër apo një pjesë të saj dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit ”.

Për tu kryer kjo veprë penale kërkohet që kryerësi i kësaj veprë penale të hyjë në posedim të pronës së paluajtshme të personit tjetër duke e pushtuar të njëjtën dhe se në momentin e hyrjes në posedim, të jetë i vetëdijshëm se nuk ka një pëlqim nga personi i tillë dhe se hyrja në posedim bëhet në mënyrë të kundërligjshme pa pasur ndonjë bazë.

E rëndësishme të kjo veprë penale është:

- Veprimi i hyrjes në posedim-pushtimi, si element objektiv i veprës penale dhe
- Dijenia se nuk ka bazë apo pëlqim nga personi tjetër (poseduesi i ligjshëm), si element subjektiv i kësaj veprë penale.

Të kjo veprë penale kërkohet që kryerësi i veprës penale të jetë i vetëdijshëm se është duke pushtuar pronën e paluajtshme të personit tjetër dhe se një gjë të tillë është duke e bërë në mënyrë të kundërligjshme, pa ndonjë bazë juridike në të cilën mbështet pretendimet për marrjen e kontrollit në pronën e paluajtshme.

Dihet se mbrojtja e pronësisë në parim bëhet përmes padisë në procedurë kontetsimore e në disa raste edhe në procedurë të veçantë siç është rasti me KPA-ne dhe atë deri në momentet kur veprimet e penguesit ose privuesit nga posedimi nuk kanë karakter penalo juridik.

Veprimet e penguesit në raport me pronën e tjetrit marrin karakter penalo juridik në momentin kur kryerësi me dashje pushton pronën e tjetrit pa pasur ndonjë bazë pronësore, ndërsa në rastet tjera kur veprimet e kryerësit në raport me pronën e personit tjetër bazohen në një pretendim të caktuar pronësor, kjo situatë ka karakter juridiko-civil dhe duhet të marr mbrojtje në procedurë kontetsimore përmes padisë për pengim posedim më të cilën kërkohet kthimi i posedimit ose padisë pronësore me të cilën kërkohet lirimi i pronës.

Gjithashtu, është me rëndësi të thuhet se personi i cili e ka vendosur posedimin në mënyrë të ligjshme, edhe nëse ndërkohë e humbet bazën e posedimit, nuk mund të konsiderohet uzurpator apo pushtues i asaj paluajtshmerie, pasi që pushtimi kryhet me një akt apo veprim që ndërmerret në momentin e vendosjes së pushtetit faktik mbi paluajtshmerinë e tjetrit.

Pra si përfundim, ligjvënësi më këtë vepër ka inkriminuar aspektin subjektiv, përkatësisht dijeninë e te pandehurit se është duke pushtuar paluajtshmerinë e tjetrit pa asnjë bazë ligjore.

d) Provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, vlerësimi dhe çmuarja e tyre;

Gjatë shqyrtimit gjyqësor para kësaj gjykata u administruan provat materiale te propozuara nga palet si në vijim: E. W. m nr.W/....., Raporti i dëbimit i dt.16.01.2012, Raporti i inspektimit dt.17.01.2012, Vendimi nr.HP....., Memorandum i dt.16.01.2012, Raport ditor MTR dt.17.01.2012, Kërkesa për administrim dt.13.09.2005, Foto dokumentacioni, Dorëzim i pronave t braktisura të Komunës së Pejës, të lëshuar nga Agjensioni Kosovar pronës me dt.28.04.2021, Vendim i vërtetuar – kërkesa e R. B. – DS 306221, Vendim i vërtetua për rishqyrtim – Sh. K. me nr.DS, Marrëveshje mbi qiranë për pronën ndërmjet KPA dhe Sh. K., si bashku e xhiro deponimin e dt.13.03.2021, Urdhër për dëbim së bashku me raportin e dëbimeve regjionale të KPA-s me dt,27.12.2011, Vërejtja e fundit lidhur me rastin DS 306221 e dt.19.11.2011, Urdhër për dëbim së bashku me raportin e dëbimeve të KPA-së me dt.18,05.2012, Urdhër për dëbim së bashku me raportin dëbimeve dt.08.11.2012, Urdhër për dëbim i dt.12.06.2015, Vërejtja e fundit për dëbim e dt.08.06.2015, Kërkesa me nr.041 nr..... dt.02.06.2003, Aktvendim i lëshuar nga Qeveria e R.Serbisë – Komisioni për çështje banesore dt.29.12.1998, Kontratë në mes të MPB-së së Serbisë dhe B. R. e dt.30.12.1998, Kërkesë nga R.B. e dt.09.09.2005, me të cilën kërkon që pronën ta vendosë nën administrimin e saj, Dokumentacioni korrespondenca ndemjet Sh. K.dhe Agjensioni Kosovar i Pronës, Konkurs për ndarje të banesave sociale në shfrytëzim dhe qira nga Komuna Pejës i dt.20.05.2011, Propozim ër aprovim të listës përfundimtare të përfituesve të banesave n shfrytëzim dhe qira nga komuna Pejës t/10.11.2011, Lista e propozuar nga Komuna Pejës për përfituesit e banesave me qira dt.25.10.2011, Vërtetim i lëshuar nga NNM Injniering – VI i dt.25.05.2007, Certificate lëshuar nga Kuvendi Komuna Pejës me dt.02.05.2007 në të cilën thuhet se R. B., nuk figuron si pronar i banesës në Komunën e Pejës, Deklaratë e dhënë nga I. E., Njoftim lëshuar nga Komuna Pejës, për përzgjedhje të përfituesve të banesave sociale në pronësi të Komunës, Vendim lëshuar nga Komuna Pejës për miratimin e propozimit të Komisionit Komunal Banesor për ndarje të banesave në shfrytëzim me qirra dt.11.11/2011, Fatura e KEK-ut në emër të Sh. K. e dt.11.02.2004 n adresë Fidanishte H-1 – Pejë, Faturë e Hidro Drinit në emër të Sh. K.e dt.01.02.2005, Banesa HI Kulla Gj/H1, Faturë nga KRM Ambienti në Pejë e dt.03.05.2005b erë të Sh. K. në adresën Kulla GJ/H-1, Faturë e tatimit në pronë e dt.13.02.2011 ë erë të Sh. K. në adresën Lla/1 hyrja C/10- Fidanishtja, Marrëveshjen mbi qiranë për pronë banesore lidhur n ndërmjet Sh. K. dhe Asgjësisë Kosovare të Pronës pr pronën në adresën F 1-1 nr.4 e dt.19.10.2010, Fletë pagesë lëshuar nga NLB Bank e dt.01.03.2013, Faturë

lëshuar nga KPA me dt.01.11.2010 në emër të Sh. K. t, me adresë “R.” Fi – 1 nr.4 me vlerë të faturës 79.54 euro, Faturë lëshuar nga KPA me dt.01.12.2010 në emër të Sh. K. t, me adresë “R.” Fi – 1 nr.4 me vlerë të faturës 79.54 euro, Faturë lëshuar nga KPA me dt.01.01.2011, në emër të Sh. K. t, me adresë “R.” Fi – 1 nr.4 me vlerë të faturës 79.54 euro, Faturë lëshuar nga KPA me dt.01.02.2011, në emër të Sh. K. t, me adresë “R.” Fi – 1 nr.4 me vlerë të faturës 79.54 euro, Faturë lëshuar nga KPA me dt.01.03.2011, në emër të Sh. K. t, me adresë “R.” Fi – 1 nr.4 me vlerë të faturës 79.54 euro, Faturë lëshuar nga KPA me dt.01.04.2011, në emër të Sh. K. t, me adresë “R.” Fi – 1 nr.4 me vlerë të faturës 79.54 euro, Faturë lëshuar nga KPA me dt.01.05.2011, në emër të Sh. K., me adresë “R.” Fi – 1 nr.4 me vlerë të faturës 79.54 euro, Fletë-deponim në merë tët KPA-së në vlerë prej 79.54 euro dt.06.korik 2011, Faturë lëshuar nga KPA me dt.01.08.2011, në emër të Sh. K. t, me adresë “R.” Fi – 1 nr.4 me vlerë të faturës 79.54 euro, Fletë deponim nga UFPP Pejë – për AKP-në vlera 79.54 euro nga Sh. K. për pagesën e qirasë dt.05.10.2011, Faturë lëshuar nga KPA me dt.01.10.2011, në emër të Sh. K., me adresë “R.” Fi – 1 nr.4 me vlerë të faturës 79.54 euro, Përgjigje nga KPA dt.01.12.2012.

Siç shihet në këtë rast janë administruar një numër relativisht i madh i provave materiale, prova te propozuara nga prokuroria dhe nga vetë i pandehuri, e me këtë rast në do të trajtojmë secilën provë dhe do të vlerësojmë aftësinë e tyre provuese.

Provat e emërtuara E. W. , raporti i dëbimit i datës 16.01.2012, Raporti i inspektimit i datës 17.01.2012 Vendimi nr, HP....., Memorandumi i datës 16.01.2012, Raporti ditor MTR 17.01.2012 kërkesa për administrim dhe foto dokumentacioni të propozuara në aktakuzë, janë prova të cilat vërtetojnë se në lidhje me të pandehurin fillimisht është vendosur që i njëjti duhet ta liroj banesën kontestuese ku i është dhënë kohë 30 ditë për lirim e së njëjtës pastaj tregojnë se i njëjti me datën e përshkruar si në aktakuzë është dëbuar nga banesa kontestuese, fakt i cili nuk është kontestues as për të pandehurin.

Këto prova për gjykatën janë bindëse dhe ta mjaftueshme për të vërtetuar faktin se i pandehuri është dëbuar nga banesa, e kjo përbën njërin nga faktet relevante të përshkruara si në aktakuzë.

Prova e emërtuar Vendim i leshura nga Republika e Serbisë me numër 360-..... i datës 29.12.1998, e cila ne përmbajtjen e sajë tregon se është vendosur që banesa dy dhomëshe nr.4,72,20 m2, objekti A, L. R. në Pejë, i jepet me qira për kohë të pacaktuar punëtorit të MBB-

së së Republikës së Serbisë R. B. i cili mund ta shfrytëzoj me anëtarët e familjes së tij të numëruar si në dispozitiv të vendimi.

Ky vendim, pranë gjykatës është i dorëzuar në kopje të shkruar në alfabetin cirilik dhe një kopje e përkthyer. Gjykata e vlerësoj këtë provë dhe erdhi në përfundim që e njëjta nuk mund të merret si provë e besueshme pasi që duke pas parasysh se nuk është e dorëzuar në origjinal, nuk mund të dihet nëse e njëjta është autentike e si rrjedhojë për gjykatën kjo provë nuk është e besueshme, aq më tepër kur dihet se e njëjta nuk përputhet me asnjë prove tjetër të pranueshme, përkatësisht nga njoftimi i pranuar nga Komuna e Pejës, si autoritet në territorin e të cilës gjendet banesa kontestuese, rezulton se në regjistrat pronësor askund nuk figuron R. B. si pronar i ndonjë paluajtshmerie.

Gjithashtu edhe kontrata për qiranë e objektit që është kontest i kësaj çështje penale, kontratë e lidhur ndërmjet MPB-së së Serbisë dhe R.B., lidhet me provën paraprake, përkatësisht vendimin për dhënien me qira të kësaj pronë, për gjykatën nuk është fare bindëse dhe nuk e vërteton faktin se personi R. B. e ka pasur në posedim pronën kontestuese, për me tepër gjykata këtë provë dhe provën paraprake nuk i mori si prova të besueshme e as relevante kur dihet se ka prova të tjera që vërtetojnë se kjo pronë i është dhënë me qira këtu të pandehurit nga ana e Agjencionit Kosovar të pronës, pra nuk ka asnjë indikacion që tregon se i pandehuri ta ketë marrë posedimin nga personi R. B..

Të gjitha provat që lidhen me veprimet e ndërmarrura nga KPA kanë të bëjnë me procedurën e dëbimit të pandehurit Sh. K., nga prona kontestuese, proces të dëbimit të cilin nuk e konteston as i pandehuri.

Prova e emërtuar Raport i Dëbimeve Regjionale të KPA-së i datës 27.12.2011, që ka të bëjë me pronën në shfrytëzim të Sh. K. , në arsyetimin e tij thekson se “Ky shfrytëzues deklaroj se nuk do të paguaj , sipas tij kam vendim prej komunës së Pejës për këtë pronë”, gjykata e analizoj me vëmendje këtë provë dhe gjeti se faktet e konstatuar në këtë raport përputhen me provat e dorëzuar nga ana e të pandehurit, përkatësisht me vendimin e Kuvendit Komunal të Pejës Për ndarjen e pronave, ku rezulton se të pandehurit i është ndarë kjo pronë nga komuna, të njëjtin përshkrim me të njëjtin arsyetim e kanë raportet e KPA-së për dëbimin, të dorëzuara si prova në këtë çështje penale.

Nga këto prova vërehet se KPA ka pasur në administrim 36 prona në Komunën e Pejës, ku prej të cilave 35 prona ja ka dorëzuar në administrim Komunës së Pejës në vitin 2011 dhe vetëm një të tjetër prej tyre nuk ja ka dorëzuar, për shkak se në lidhje me këtë pronë ka pasur kërkesë individuale, të njëjtën KPA e ka mbajtur në administrim.

Me provën e emërtuar Konkurs për ndarjen e banesave sociale në shfrytëzim, vërtetohet se Komuna e Pejës, më datën 20.05.2011 ka shpallur konkursin 01-....., me të cilën ka njoftuar se bën ndarjen e 30 banesave në shfrytëzim me qira, për raste sociale, të cilat banesa gjenden në Lagjen 7 Shtatori (F.) ndërtesa A, e me çratis edhe janë përshkruar kriteret e aplikimit.

Prova e emërtuar Propozimi i Komisionit Komunal Banesor, i datës 25.10.2011, paraqet listën e personave që janë përfitues të banesave në shfrytëzim ku në nr.4 të kësaj liste është i përshkruar i pandehuri Sh. K. si përfitues i banesës nr.4, në katin e II. Përmes kësaj prove vërtetohet pretendimi i të pandehurit se i njëjti ka qenë shfrytëzuesi banesës kontestuese në bazë të një procedurë ligjore të udhëhequr nga Komuna e Pejës dhe se shfrytëzimin e kësaj banese e ka marrë mbi bazën e kësaj procedure.

Prova e emërtuar Vërtetim e lëshuar nga NNN "I.-BL", tregon se kjo ndërmarrje nuk posedon të dhëna që tregojnë se R. B. ka pasur kontratë për shfrytëzimin e ndonjë banese.

Prova e emërtuar Certifikate e lëshuar nga Komuna e Pejës-Drejtoria për Kadastër me numër 01-3... e datës 02.05.2007 tregon se sipas evidencës së kësaj drejtorie R. B. nuk evidentohet si pronar i ndonjë banesë në KK Pejë.

Prova emërtuar vendim e lëshuar nga Komuna e Pejës, shihet se është aprovuar propozimi i Komisionit Komunal Banesor për ndarjen e banesave në shfrytëzim me qira për rastet sociale në objektin banesor që gjendet në Rr. "7 shtatori", Lagjeja F. ndërtesa A, ku shihet se këtu të pandehuri Sh. K. i është ndarë banesa numër katër në katin e dytë.

Prova e emërtuar marrëveshja mbi qiranë e pronës banesore e lidhur ndërmjet këtu të pandehurit Sh. K. dhe Agjencisë Kosovare të Pronës me datë 19.10.2010, vërteton se banesa kontestuese e përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës i është dhënë më qira këtu të pandehurit në këmbim të pagesës së vlerës së qirasë në lartësi prej 79.54 euro, kontratë me kohëzgjatje prej

12 muajsh. Kjo kontratë për gjykatën është provë bindëse dhe me të vërtetohet se këtu i pandehuri mbi bazën e një raporti me KPA-në e ka mbajtur në posedim banesën kontestuese.

Provat si fatura e KEK e datës 11.02.2004, fatura e kompanisë Hidrodrini e datës 01.02.2005 dhe fatura e K.R.M Ambienti e datës 01.03.2005, të lëshuara për konsumatorin Sh. K. në adresën përkatësisht banesën që është objekt kontesti, vërtetojnë se këtu i pandehuri Sh. K. e ka pasur në posedim banesën kontestuese shume vite para datës së kryerjes së veprës penale e cila përshkruhet në aktakuzë.

Prova e emërtuar Fletëpagesë e lëshuar nga NLB Banka e dt.01.03.2013 vërteton se këtu i pandehuri Sh. K. ka bërë pagesë në emër të qerasë, pagesë kjo e bërë në llogarinë e KPA-së. Me anë të kësaj prove vërtetohet raporti i qiramarrjes në mes të pandehurit dhe këtu të dëmtuarës dhe se edhe njëherë provon bazën e posedimit të banesës kontestuese nga i pandehuri.

Një provë tjetër shumë e rëndësishme është Përgjigjja e KPA-së me numër Ref:.....eg e datës 10.12.2012, drejtuar këtu të pandehurit Sh. K. , me të cilën përgjigje i pandehuri është njoftuar se nuk ka mundësi ti lejohet qëndrimi në banesë pa paguar qiranë, e më anë të kësaj vërtetohet se kontesti në lidhje me posedimin e kësaj banese ka të bëjë më mos pagesën e qerases të përcaktuar në kontratën që u administrua si provë me lartë.

I pandehuri Sh. K. në mbrojtjen e tij të dhënë në gjykatë deklaroi së “banesën e cila është e përshkruar si ne aktakuze, jam i vendosur ne te qe nga 26.06.1999, ne atë kohe banesa ka qene e pa ndërtuar, vetëm muret e jashtme kane qene , jam vendosur aty unë dhe te gjithë banoret e tjerë te cilët jetojnë edhe sot aty , duke e vendosur infrastrukturën siç janë: ujin, kanalizimin, rryma ,na e kemi bo te banueshme atë objekt , ne vitin 2000 apo 2001 kane nisur me ardh habitati ngase ato banesa i ka mare ne administrim, ato banesa kane qene te ndërtuar për polic dhe ushtaraket për mu kthye ne Kosove, ato banesa sot akoma ne gjeodezi figurojnë vetëm si parcela , pra ato nuk janë te regjistruara fare ne kadastër, me pas te gjithë banoret jemi ankuar ne habitat ,për shkak se habitati ka deshtë me na largu te gjithëve prej atyhit , ne atë hyjmë ekzistojnë 10 banesa , asnjë prej këtyre banoreve përreth meje nuk janë larguar nga aty , përveç meje qe me ka vazhdu landa , jam takuar me zyrtaret e habitatit ne Prishtine , aty kame bere marrëveshje për qira te kësaj banese, ne vitin 2011 drejtorati për mirëqenie sociale ne Peje , pas marrëveshjes qe ka pasur me habitain , ka marur ne administrim 36 banesa ne Peje , ne mesin e tyre është edhe banesa ime , pastaj banesa mua mu ka ndare për shfrytëzim , me pagesës mujore, nga ana e

komunës, ku kam vazhduar me jetua aty , ne te njëjtën kohe kame paguar qira edhe komunës edhe habitatit , sot vazhdoj me jetua aty , e kame rindërtuar banesën me këto mundësi qe kam, me një vendim te qeveris se Kosovës mu ka ndërpre qiraja prej habitatit, pastaj kame vazhduar me qiranë e komunës.

Sa i përket aspektit pronësore këto banesa janë jo ekzistente ngase nuk janë te regjistruara askund”.

Nga mbrojtja e të pandehurit rezulton se i njëjti nuk e konteston faktin se e ka në posedim parcelën kontestuese edhe mirëpo sipas mbrojtjes së tij këtë parcele e ka në posedim në bazë të qerasë më KPA-në dhe me pastaj në bazë të qerasë me Komunën e Pejës.

Mbrojtja e të pandehurit përputhet në tersi edhe me provat e administruara në shqyrtim gjyqësor siç janë kontrata për qiranë e banesës ndërmjet të pandehurit dhe KPA-së dhe vendimi për ndarjen ne shfrytëzim të banesës nga ana e Komunës së Pejës.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare mbeti në tersi pran akuzës, duke shprehur bindjen se me provat e administruara është arritur qe të vërtetohet në tersi aktakuza sa i përket veprës penale Pushtim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 259 par.1 të KPK-së dhe propozoj qe i akuzuari të shpallet fajtor dhe te dënohet sipas ligjit, ndërsa sa i përket veprës penale Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 322 par.1 të KPK-së, prokurori propozoi qe aktakuza të refuzohet në këtë pikë për shkak se kjo vepër penale është parashkruar.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se mbetet në tersi pranë deklarimeve të prokurorit të shtetit.

e) Vlerësimi përfundimtar i gjykatës në lidhje me çështjen(Vëndimi në lidhje me fajsinë);

Gjykata duke u bazuar ne nenin 7 dhe nenin 8 par.2 të KPPRK-së i vlerësoj provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, duke analizuar me vëmendje fuqinë e tyre provuese, duke vlerësuar nëse secila prove veç e veç dhe te gjitha së bashku vërtetojnë faktet relevante – vendimtare për të cilat ngarkohet i pandehuri dhe si rrjedhojë nxori përfundimet si në vijim.

Është vërtetuar pa asnjë dyshim fakti së i pandehuri Sh. K. ka në posedim banesën në Fidanishte F2, ap.4 në Pejë, gjë qe nuk kontestohet as nga vetë i pandehuri.

Në këtë çështje penale nuk është vërtetuar fakti qendrorë që ishte pretendim i prokurorisë në aktakuzë, fakti se i pandehuri e ka uzurpuar në mënyrë të kundërligjshme, përkatësisht e ka pushtuar pronën kontestuese pa pasur ndonjë pretendim pronësor.

Përkundrazi, gjatë shqyrtimit gjyqësor u vërtetua e kundërta e kësaj, se këtu i pandehuri e ka mbajtur në posedim këtë banesë në bazë të kontratës për qiranë, fillimisht përmes kontratës së lidhur ndërmjet të pandehurit dhe KPA-së më datën 19.10.2010 e me pastaj në mes të pandehurit dhe Komunës së Pejës në bazë të vendimit të komunës të datës 11.11.2011, pra vendim i komunës lëshuar vetëm dy muaj para datës që konsiderohet si datë e kryerjes së veprës penale.

Pa mëdyshje është vërtetuar fakti se i pandehuri Sh. K. e ka marrë me qera banesën kontestuese dhe se kjo ka qenë baza mbi të cilën i njëjti ka hyrë në posedim të kësaj pronë.

Është shumë me rëndësi fakti se në këtë rast në lidhje me banesën kontestuese janë zhvilluar paralelisht raportet kontraktuale në mes të pandehurit dhe KPA-së dhe në mes të pandehurit dhe Komunës së Pejës, ku me këtë të fundit i pandehuri ka vendosur raportin e qerasë vetëm dy muaj para datës së kryerjes së veprës penale siç ngarkohet në aktakuzë.

Për gjykatën ky fakt është shumë me rëndësi në përcaktimin e aspektit subjektiv të veprës penale, përkatësisht të veprimeve të kryerësit, ku gjykata pa mëdyshje konkludoi se duke qenë në raporte qiraje më të dy institucionet, përkatësisht duke pasur një vendim të ri nga ana e komunës, i pandehuri është gjendur në situatë konfuzioni në lidhje me të drejtën e tij mbi banesën kontestuese, i pandehuri më të drejtë e ka konsideruar si të bazuar posedimin e pronës kontestuese kur e ka ditur se e ka një vendim të Komunës për ndarjen e kësaj banese.

Pra nga kjo rezulton se tek i pandehuri nuk ka ekzistuar dashja për kryerjen e veprës penale, nuk ka qenë qëllimi i tij që të pushtoj një pronë mbi të cilën nuk ka asnjë të drejtë, përkundrazi ai ka marrë në posedim pronën për të cilën në atë kohë ka pasur një vendim të vlefshëm të lëshuar nga Komuna e Pejës.

Duke u bazuar në këto fakte, gjykata erdhi në përfundim se tek i pandehuri S. mungon aspekti subjektiv i vaporesh penale, mungon dashja si formë e fajësie për kryerjen e veprës penale, e në

mungesë të këtij elementi nuk mund të ketë as vepër penale në këtë rast, kur dihet se vepra penale më të cilën ngarkohet i pandehuri është vepër penale me karakter te fortë subjektiv.

Për gjykatën në procedurë penale, nuk është relevante fakti nëse kontrata e qirasë është përmbushur apo nuk është përmbushur nga i pandehuri apo nga cilado prej palëve, pasi kjo çështje mund të jetë objekt shqyrtimi në procedurë kontestimore apo administrative në rastin e raportit me KPA-në, e rëndësishme për gjykatën është se ky raport nuk ka karakter penal.

Në procedurë penale është me rëndësi aspekti subjektiv - përkatësisht fakti se i pandehuri në momentin e marrjes së posedimit të paluajtshemrisë a ka qenë i bindur se ka ndonjë bazë për marrjen e posedimit apo i njëjti duke e ditur se nuk ka kurrfarë bazë, me dashje e pushton paluajtshemrinë e tjetrit.

E në rastin e të pandehurit Sh. K. , siç u tha edhe me lartë pa kurrëfar mëdyshje është vërtetuar se i njëjti pronën kontestuese e ka futur dhe mbajtur në posedim në bazë të një kontrate të qirasë filimisht me KPA-ne e pastaj me Komunën e Pejës, kjo e fundit e vlefshme edhe përgjate kohes se pershkruar si ne dispozitiv te aktauzes.

Si përfundim, nuk ka mëdyshje se me provat e administrua në shqyrtim gjyqësor u vërtetua se vepra me të cilën akuzohet i pandehuri nuk përbën vepër penale dhe se faktet e paraqitura si në aktakuzë përkatësisht dispozitiv të këtij aktgjykimi mund të jenë objekt shqyrtimi vetëm në procedurë kontestimore apo administrative, andaj gjykata të kuptim të nenit 363 par.1 pika 1.1 të KPRK-së të pandehurin e liroj nga akuza sa i përket veprës penale Pushtim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 259 npar.1 te KPK-së.

Për vepren penale Heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 322 par.1 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës gjykata në kuptim të nenit 362 par.3 të KPPRK-së mori aktgjykim refuzues, për shkak se gjeti se në lidhje me këtë veper penale është arritur afati i parashkrimit absolut të ndjekjes penale, gjë të cilën e potencoj edhe prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare.

Për këtë vepër penale është parapara mundësia e shqiptimit të dënimit më burgim prej tre muajve deri ne tre vjet, ndërsa nëse e shikojmë kohën e kryerjes së kësaj vepre penale te përshkruar si në aktakuzë rezulton se kanë kaluar më shumë së 11 vite nga ajo kohë.

Kur analizohet në kontekst të nenit 90 par.1 pika 3 në lidhje me nenin 91 par.6 të KPK-së, rezulton se në këtë rast pas kalimit të gjashtë viteve është arritur parashkrimi absolut ndjekjes penale, si rrjedhojë gjykata në kuptim të nenit 362 par.3 të KPPRK-së mori aktgjykim refuzues.

f) Shpenzime të procedurës dhe kërkesa pasurore juridike;

Kur u vendos në lidhje me shpenzimet e procedurës gjykata u bazua në nenin 453 par.1 të KPPRK-së, ku thuhet “Kur pushohet procedura penale apo kur merret aktgjykim me të cilin i pandehuri lirohet nga akuza ose me të cilin refuzohet akuza, gjykata në aktvendim apo në aktgjykim shënon se shpenzimet e procedurës penale nga neni 449, paragrafi 2 nën-paragrafi 2.1 deri në 2.5 të këtij Kodi, shpenzimet e nevojshme të pandehurit dhe kompensimi i shpenzimeve të nevojshme të mbrojtësit paguhen nga mjetet buxhetore, përveç në rastet e caktuara në paragrafët vijues të këtij neni”.

Në bazë të nenit 462 par.1 të KPPRK-së, e dëmtuara u udhëzua që kërkesën pasurore juridike ta realizoj në kontet të rregullt civil.

Andaj, duke u mbështetur në të thënat si me lartë dhe në kuptim të nenit 362 par.1 pika 3, nenit 363 par.1 pika 1.1 dhe neni 369 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMLORE PEJË

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.184/12, me datë 08.12.2023

Procesmbajtësja:

Shpresa Kërnia

Gjyqtari i vetëm gjygues:

Leon Përlaska

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga pranimi i të njëjtit, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.